



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1758 / prot.
12

Tiranë, më 31.10.2025

V E N D I M

I KËSHILLIT DREJTUES

Nr. 32 datë 30/10 /2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT “MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR NDËRTIMIN E BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË GRAMSH

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sipas njoftimit nr.1758 prot, datë 22.10.2025, pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm, për miratimin e draft Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Gramsh”, i përgatitur nga Drejtoria Juridike, mbështetur në Ligjin nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave” i ndryshuar, si dhe në shkronjën (f) të nenit 14, të Statutit të EKB-së protokolluar me tonën nr.prot.1177/1 datë 04.10.2024:

V E N D O S I:

1. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Gramsh”, sipas draftit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Enkelejd Musaberr

